

**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“DITË E NATË Online” Sh.p.k.**

Sot me date 31 dhjetor 2020 (dymijë e njëzete), palet e meposhtme:

**Shoqëria “DITË E NATË” Shpk**, nje shoqeri e se drejtes Shqiptare rregjistruar ne QKB me date 17/02/2020 me NIPT : M01417001E. Me seli ne adresen : Rruga "Kongresi i Manastirit", Nr.44/11, Tirane, Shqiperi e perfaqesuar nga Zj. Klodiana Stopani shtetase shqiptare, e lindur ne Fier me 04.08.1981, mbajtës i letërnjoftimit me nr personal nr.I15804002K.

Si dhe

**Z. Szymon Kajetan Komorowski**, shtetas Polak, i lindur ne Varshve, Poloni me 13.11.1979, mbajtës i letërnjoftimit me nr DBI 076786 dhe nr personal nr. 79111302170.

Kane vendosur te nënshkruaje Statutin e mëposhtëm te një shoqërie me përgjegjësi te kufizuar, aktiviteti i se cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe nga ky Statut.


**KAPITULLI I**  
**FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA**

**Neni 1 – Forma**

- 1.1 Shoqëria **“DITË E NATË Online” Sh.p.k.** (ne vijim “Shoqëria”) krijohet ne formën e një shoqërie me përgjegjësi te kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me ane te këtij Statuti dhe Aktit te Themelimit.
- 1.2 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 1.3 Akti i Themelimit dhe Statuti janë ne përputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshëm, ndërsa çështjet qe nuk janë shprehimisht te parashikuara ne to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 2 – Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është **“DITË E NATË Online” Sh.p.k.**



### Neni 3 – Objekti i shoqërisë

3.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare ne përputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

3.1 Ne menyre me specifike, Shoqëria do te kryeje aktivitet tregtar:

- tregtim medikamentesh, suplementesh, shtesash ushqimore, produkte kozmetike dhe medikal device online me pakice etj. Shoqëria do te mund te kryeje cdo aktivitet te ligjshem tregtar import, eksporti, tregtia me shumice e pakice te mallrave, cdo aktivitet qe lidhet me cfare dolloj pasurie te luajtshme dhe/ose te paluajtshme, duke perfshire por pa u kufizuar vetem ne blerjen, shitjen, transferimin, ndertimin, nen-kontraktimin, disponimin, posedimin, menaxhimin, marrjen apo dhenin me qira, leasing e pasurive te luajtshme dhe/ose te paluajtshme, dhenien e fitimin e cdo te drejte apo privilegji ne lidhje me keto pasuri. Shoqëria mund te kryeje aktivitetit publikimi dhe reklamimi. Gjithashtu shoqëria do te kryeje cdo lloj aktiviteti tjetër sic mund te konsiderohet i nevojshem apo i dobishem apo ndihmes ne permbushjen e qellimeve te mesiperme.

3.2 Për realizimin e qëllimeve të saj shoqëria mund:

- Të japë me qere ose në pronësi llojet e instalimeve qe kanë në zotërim dhe qe i shërbejnë veprimtarisë së saj kurdo herë dhe kudo që gjenden.
- Te themelojë dhe/ose të behet bashkëpjesëtarë në çfarëdolloj ndërmarrje në Shqipëri ose jashtë shtetit, me të njëjtin qëllim apo të përafërt që funksionon në çdo formë ligjore.

### Neni 4 - Selia

4.1 Selia e Shoqërisë është ne Adresën : Njesia Bashkiake Nr.10,Rruga Islam Alla, Nr 32, kryqezimi i Rruges Islam Alla me Rrugen Myslym Shyri, Tirane, Shqipëri.

4.2.Transferimi i selise se Shoqerise ne nje vend tjetër behet me vendimin e Asamblese se Ortakeve.

4.3.Asambleja e Ortakeve mund te vendose hapjen e filialeve, degeve dhe perfaqesive te Shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise.

### Neni 5 – Kohezgjatja e veprimtarise

5.1Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete per nje afat te pacaktuar.



## KAPITULLI II

### KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

#### Neni 6 – Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1,000 Leke (një mijë leke).
- 6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbehet nga 2 (dy) kuota, te gjitha te nënshkruara, me vlere nominale 1,000 leke (një mijë leke).

#### Neni 7 - Kontributet

7.1 Kontributi ne kapitalin e shoqërisë është ofruar si me poshtë:

-Ortaku **Shoqeria "DITË E NATË" Shpk** ka ofruar një kontribut ne para te barabarte me 900 leke (nenteqind leke).

-Ortaku **Z. Szymon Kajetan Komorowski** ka ofruar një kontribut ne para te barabarte me 100 leke (njëqindë leke).

7.2 Sipas kontributeve te mësipërme:


--Ortakut **Shoqerise "DITË E NATË" Shpk** i përket 1 (një) kuote, qe i korrespondon me 90% (nentedhjet përqind) te kapitalit te Shoqërisë.

-Ortakut **Z. Szymon Kajetan Komorowski** i përket 1 (një) kuote, qe i korrespondon me 10% (njëqind përlind) te kapitalit te Shoqërisë.

#### Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

8.1 Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne çdo moment, një ose disa here, me vendim te Asamblesë se Ortakeve.

8.2 Ne rast rritjeje te kapitalit, te gjithë ortaket kane te drejtën te nënshkruajnë rritjen ne raport me pjeset e kapitalit te zoteruara. Ne rast se disa nga ortaket nuk e ushtrojne kete te drejte, pjesët e tyre mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere proporcionalisht me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.



## **Neni 9 – Zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar**

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakeve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakeve në të njëjten masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.
- 9.3 Çdo lloj investimi në kapital i cili ndryshon përqindjet e pronësive, do të duhet të aprovohet në mënyrë unanime nga të dy ortakët e shoqërisë, pavarësisht përqindjes së zotëruar në kapital.

## **Neni 10 – Transferimi i kuotave**


- 10.1 Kuotat janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakeve.
- 10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërbllim ashtu edhe pa shpërbllim në kuptimin me të gjere të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjera të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet me parë t'i ofrohen në parablërje ortakeve të tjera.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjera, me leter rekomandë me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablërjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pësembedhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomandë, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablërjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablërjes.
- 10.5 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablërjes, kuotat mund t'u transferohen të treta plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakeve.

## **KAPITULLI III**

### **ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL**

#### **Neni 11 – Asambleja e ortakeve dhe kompetencat e saj**

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakeve.
- 11.2 Asambleja e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emerimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabel e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja





e shoqerise, miratimi i bilancit dhe per çdo vendim tjeter parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni perkates.

### **Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës**

12.1 Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamble, te paraqese mendimin e tij dhe te jape aq vota sa eshte numri i kuotave qe ai zoteron.

12.1 Çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje person tjeter jo-ortak, i pajisur me prokure me shkrim, me anen e se ciles mund te jape voten e tij.

12.3 Ortaku nuk mund te leshoje prokure per votim per nje pjese te kapitalit qe zoteron, ne qofte se voton personalisht per pjesen e mbetur.

### **Neni 13 – Thirrja e Asamblese se Ortakeve, Kuorumi dhe Vendimet**

13.1 Asambleja e Ortakeve thirret te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e bilancit, te raportit te Administratorit, ekspertit kontabel sidhe inventarit.

13.2 Asambleja mund te thirret ne çdo moment nga nje prej Administratoreve si edhe prej nje ose disa ortakeve qe perfaqesojne te pakten 5% (pese perqind) te kapitalit themeltar. Asambleja duhet te thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande me kthim pergjigje qe duhet t'u dergohet ortakeve – ne adresen qe rezulton ne Librin e Ortakeve – dhe ekspertit kontabel (nese eshte emeruar), te pakten 15 (pesembedhjete) dite perpara mbledhjes se Asamblese. Thirrja duhet te permbaje informacion mbi llojin e Asamblese, mbi çeshtjet qe do te trajtohen dhe per te cilat do te merret vendim, mbi vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte.

13.3 Asambleja mund te thirret edhe jashte selise se Shoqerise.

13.4 Ne rast se Asambleja e Ortakeve nuk mblidhet me thirjen e pare per mungesen e kuorunit te parashikuar ne piken 13.7 te ketij Statuti, Asambleja e Ortakeve do te thirret brenda 30 (tridhjete) ditesh me te njejtin rend dite.

13.5 Mbledhjet e Asamblese mund te mbahen edhe nepermjet telekonferences dhe videokonferences, me kusht qe te gjithe pjesemarresit te mund te identifikohen dhe t'u lejohet atyre te ndjekin diskutimin dhe te nderhyjne ne momentin e trajtimit te çeshtjeve ne rend te dites; pasi te jene verifikuar keto kerkesa qe duhet te rezultojne ne procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari ne te cilin duhet te ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.

13.6 Asambleja do te thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve te njoftimit, ne rast se jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne te tere kapitalin themeltar.

13.7 Vendimet e Asamblese se Ortakeve, per te cilat kerkohet nje shumice e thjeshte, jane te vlefshme nese jane te pranishem ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30% (tridhjete perqind) te kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblese se Ortakeve qe kerkojne nje shumice te cilesuar, jane te vlefshme nese jane te pranishem ortaket me te drejte vote qe zoterojne te pakten 51% (pesedhjete e nje perqind) te kapitalit themeltar.

13.8 Asambleja e Ortakeve vendos ndryshimet e satutit, zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit, transferimin e kuotave, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, me voten pro te  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e ortakeve te pranishem qe zoterojne te pakten 51% (pesedhjte e nje perqind) te kapitalit themeltar. Ne te gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakeve merr vendime me shumice te thjeshte votash te ortakeve qe zoterojne me shume se 30% (tridhjete perqind) te kapitalit themeltar.

13.9 Cdo Asamble drejtohet nga nje ortak ose ndonje person tjetër i caktuar nga vete Asambleja. Per pasqyrimin e vendimit Asambleja emerone nje Sekretar, qe mund te jete edhe jo-ortak.

13.10 Vendimet e Asamblese duhet te nenshkruhen nga Kryetari i Asamblese dhe nga Sekretari.

#### Neni 14 – Administrimi

14.1 Shoqeria administrohet nga te pakten 1 (nje) Administrator i cili do te qendroje ne detyre deri ne shkarkim apo doreheqje ose per nje periudhe prej 5 (pese) vitesh.


14.2 Perfaqesimi ligjor i Shoqerise me palet e treta i besohet Administratorit. Administratori mund te ushtroj fuqite konform me sa parashikohet ne nenin 95 te Ligjit n. 9901 te dates 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare". Ne perputhje me parashikimet ligjore, administatorit do te kete kufizimet si me poshte vijojne:

- Administratorit i lejohet te hyje ne marredhenie kontraktuale me Kliente/Furnitore/ Pale te tjera te treta kur vlera e marreveshjes nuk kalon shumen limit 100 000 ( njeqind mije ) leke. Per cdo veprim mbi kete shume duhet te marre autorizim te posacem nga Asambleja e Pergjithshme.
- Administratori nuk mund te marre vendime ne lidhje me politikat tregtare dhe strategjike te shoqerise pa marre paraprakisht autorizimin e Asamblese te Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme me vendim te brendshem percakton vendimet e karakterit operacional te cilat mund te merren nga administratori pa aprovimin e Asamblese se Pergjithshme.
- Administratorit i lejohet te kryeje veprime bankare deri ne shumen limit 100 000 ( njeqind mije) leke. Per cdo veprim mbi kete shume duhet te marre autorizim te posacem nga ortaket e shoqerise.

14.5 Me kete akt emerohet 1 (nje) Administrator i Shoqerise personi si me poshte:

**-Z. Redi Goga**, shtetas shqiptarë, i lindur ne Fier me 27.12.1988, mbajtës i letërnjoftimit me nr 031528207 dhe nr personal nr.I81227074K.

14.6 Administratoret mund te emerone perfaqesues te posacem per veprime apo kategori te caktuara veprimesh.



### **Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar**

- 15.1 Ne rast se kerkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakeve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabel te Shoqerise mund t'i besohet nje ose disa eksperteve kontabel te autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

## **KAPITULLI IV**

### **VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE**

#### **Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor**

- 16.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit
- 16.2 Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicen e kerkuar nga Ligjit n. 9901 te dates 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare".
- 16.4 Miratimi i dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi i vitit financiar.

#### **Neni 17 – Fitimet**

- 17.1 Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor, u shperndahen ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara.
- 17.2 Asambleja mund te vendose edhe zbritje te veçanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo dhe shtyrjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.





**KAPITULLI V**  
**SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

**Neni 18 – Prishja**

18.1 Shoqeria priset me perfundimin e afatit te parashikuar nga Statuti, ose perpara perfundimit ne rastet e parashikuara nga ligji, ose me ane te nje vendimi te Asamblese se Ortakeve, me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut.

18.2 Shoqeria nuk priset ne rast te humbjes se zotesise per te vepruar, vdekjes, ose falimentimit te ortakeve.

**Neni 19 – Likuidimi**

19.1 Ne rast prishje, Shoqeria duhet te likuidohet.


19.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja emeron nje ose me shume likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin te Shoqerise, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.

19.3 Me perfundimin e procedures se likuidimit, Asambleja do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi punen e kryer nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.

19.4 Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do t'i shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ortakeve, ne proporcion me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

**Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

20.1 Te gjitha mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij statuti dhe aktit te themelimit, si edhe ato qe mund te lindin ne pergjithesi midis ortakeve (pervec atyre personale apo jashte Shoqerise) ose midis nje apo me shume ortakeve dhe Shoqerise, do te zgjidhen ne menyre miqesore dhe do te diskutohen ne menyre te drejtperdrejte ndermjet paleve te interesuara.





20.2 Ne rast se nuk arrihet ne nje zgjidhje miqesore te mosmarreshjes, ato do t'i besohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

### Neni 21 – Gjuha

21.1 Ky Statut është hartuar ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe .

### ORTAKET E SHOQERISE


Shoqeria “DITË E NATË” Shpk

Perfaqesuar nga

Zj. Klodiana Stopani

Z.Szymon Kajetan Komorowski

Klodiana Stopani



Szymon Komorowski

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“DITË E NATË Online” Sh.p.k.**

Sot me date 31 dhjetor 2020 (dymijë e njëzete), palet e meposhtme:

**Shoqeria “DITË E NATË” Shpk**, nje shoqeri e se drejtes Shqiptare rregjistruar ne QKB me date 17/02/2020 me NIPT: M01417001E. Me seli ne adresen: Rruga "Kongresi i Manastirit", Nr.44/11, Tirane, Shqiperi e perfaqesuar nga Zj. Klodiana Stopani shtetase shqiptare, e lindur ne Fier me 04.08.1981, mbajtës i letërnjoftimit me nr personal nr.I15804002K.

si dhe

**Z. Szymon Kajetan Komorowski**, shtetas Polak, i lindur ne Varshve, Ploni me 13.11.1979, mbajtës i letërnjoftimit me nr DBI 076786 dhe nr personal nr. 79111302170.

Kane vendosur te nënshkruaje Aktin e Themelimit e meposhtem te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar (me poshte “Shoqeria”), aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij akti.

**Neni 1 - Emertimi**

Emertimi i Shoqerise eshte **“DITË E NATË Online” Sh.p.k.**

**Neni 2 - Selia**

Selia e Shoqerise eshte: Njesia Bashkiake Nr.10,Rruga Islam Alla, Nr 32, kryqezimi i Rruges Islam Alla me Rugen Myslym Shyri, Tirane, Shqipëri.

**Neni 3 - Kohezgjatja**

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete per nje afat te pacaktuar.



## Neni 4 – Objekti i shoqerise

4.1 Shoqeria ka per objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

4.1 Ne menyre me specifike, Shoqeria do te kryeje aktivitet tregtar:

- tregtim medikamentesh, suplementesh, shtesash ushqimore, produkte kozmetike dhe medikal device online me pakice etj. Shoqeria do te mund te kryeje cdo aktivitet te ligjshem tregtar import, eksporti, tregtia me shumice e pakice te mallrave, cdo aktivitet qe lidhet me cfare dolloj pasurie te luajtshme dhe/ose te paluajtshme, duke perfshire por pa u kufizuar vetem ne blerjen, shitjen, transferimin, ndertimin, nen-kontraktimin, disponimin, posedimin, menaxhimin, marrjen apo dhenin me qira, leasing e pasurive te luajtshme dhe/ose te paluajtshme, dhenien e fitimin e cdo te drejte apo privilegji ne lidhje me keto pasuri. Shoqeria mund te kryeje aktivitetit publikimi dhe reklamimi. Gjithashtu shoqeria do te kryeje cdo lloj aktiviteti tjetër sic mund te konsiderohet i nevojshem apo i dobishem apo ndihmes ne permbushjen e qellimeve te mesiperme.

4.2 Për realizimin e qëllimeve të saj shoqëria mund:

- Të japë me qera ose në pronësi llojet e instalimeve qe kanë në zotërim dhe qe i shërbejnë veprimtarisë së saj kurdo herë dhe kudo që gjenden.
- Te themelojë dhe/ose të behet bashkëpjestare në cfardolloj ndërmarje në Shqipëri ose jashtë shtetit, me të njëjtin qëllim apo të përafert që funksionon në cdo formë ligjore.

## Neni 5 – Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1,000 Leke (një mije leke).


5.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbehet nga 2 (dy) kuota, te gjitha te nënshkruara dhe te shlyera.

## Neni 6 - Kontributet

6.1 Kontributi ne kapitalin e shoqërisë është ofruar si me poshtë:

-Ortaku **Shoqeria "DITË E NATË" Shpk** ka ofruar një kontribut ne para te barabarte me 900 leke (nenteqind leke).

-Ortaku **Z. Szymon Kajetan Komorowski** ka ofruar një kontribut ne para te barabarte me 100 leke (njëqindë leke).



6.2 Sipas kontributeve te mësipërme:

-Ortakut **Shoqerise "DITË E NATË" Shpk** i përket 1 (një) kuote, qe i korrespondon me 90% (nentedhjet përqind) te kapitalit te Shoqërisë.

-Ortakut **Z. Szymon Kajetan Komorowski** i përket 1 (një) kuote, qe i korrespondon me 10% (njëqind përlind) te kapitalit te Shoqërisë.

### **Neni 7 – Transferimi i kuotave**

Kuotat i transferohen te treteve sipas parashikimeve te Statutit.

### **Neni 8 – Administrimi**

8.1 Me kete akt emerohet 1 (nje) Administrator i Shoqerise personi si me poshte:

-Z. Redi Goga, shtetas shqiptarë, i lindur ne Fier me 27.12.1988, mbajtës i letërnjoftimit me nr 031528207 dhe nr personal nr.I81227074K.

8.2 Administratori do te ushtroje te gjitha kompetencat e administrimit te zakonshem, ne perputhje me parashikimet e nenit 14 te Statutit.

8.5 Administratorit i jepet te gjitha kompetencat e nevojshme per te kryer te formalitetet e permbushjen e detyrimeve te parashikuara per themelimin e Shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi. Per kete qellim, Administratoret, mund t'u drejtohen per ndihme te treteve ose konsulenteve te cileve mund te delegojne ne teresi ose pjeserisht kryrjen e aktivitetit te siperpermendur.

8.6 Administratori eshte gjithashtu i autorizuar te veproje ne emer te Shoqerise ne formim e siper deri ne regjistrimin e saj prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ai eshte gjithashtu i autorizuar, te firmosi te gjitha aktet dhe te marre persiper detyrime ne emer te Shoqerise qe rrjedhin prej momentit te regjistrimit te saj si edhe ka te drejte t'i delegoje kompetencat e tyre personave te tjere.

### **Neni 9– Gjuha**

9.1 Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe.




**ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE**

**Shoqeria "DITË E NATË" Shpk**


**Perfaqesuar nga**

**Zj. Klodiana Stopani**



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Klodiana Stopani', written over a horizontal line.

**Z.Szymon Kajetan Komorowski**



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Szymon Komorowski', written over a horizontal line.